



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 57

Prishtinë, më 24.03.2016, në orën 15:15

Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selville Halimi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj dhe Danush Ademi.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardian Bajraktari - MD, Taulant Kryeziu - MD, Dren Ajeti - GLPS, Arton Demhasaj – ÇOHU, Mërgime Kajtazi - KDI, Blerta Bejtullahu – EUSR/EV Office, Rinor Hoxha - MIE dhe Agnesa Haxhiu - KDI.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115

Kryesuesja-Në fjalën e saj hyrëse lexoi para anëtarëve të komisioni propozimin, të cilin Grupi për Studime Juridike dhe Politike e ka paraqitur në lidhje me transferimin e gjyqtarëve nëpër gjykata të tjera, duke theksuar se ky grup ka dhënë edhe arsyetimet për këtë çështje.

Armend Zemaj– Në fjalën e tij ua bëri me dije të pranishmëve se ligji është në fuqi dhe se aty përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Gjyqësor, duke theksuar se në ligj lejohen lëvizjet, por u shpreh kundër caktimit të periudhës kohore vetëm gjashtë muaj, duke kërkuar një periudhe kohore të arsyeshme në rastet kur gjykata tjetër ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e lëndëve. Deputeti Zemaj theksoi se duhet të rritet numri i gjyqtarëve dhe numri i prokurorëve. Në këtë fushë kërkohet efikasitet dhe efektivitet. Lëvizja nëpër gjykata nuk duhet të shihet si dhunë, por duhet kuptuar si detyrë në ngritje të efikasitetit. Kjo sipas tij është arsyeja pse duhet të procedohet në këtë formë siç është tani.

Nezir Çoçaj- Propozoi që të dëgjohet arsyetimi i anëtarit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike në lidhje me atë se çka kanë paraqitur me shkrim dhe pastaj të vendoset në Komision si të veprohet më tutje.

Dren Ajeti - Shprehu keqardhje për ligjet bazike, ku tha se po kalohen me procedurë të përshpejtuar, kur dihet se këto ligje kërkojnë një konsensus më të gjërë. Ai gjithashtu, sqaroi se analiza që është bërë nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, ku për bazë është marrë Karta evropiane për statutin e gjyqtarëve, që është akt juridik i Këshillit të Evropës, e sidomos konsultimi me nenin 3.4, ku thuhet se: gjyqtarët mund të transferohen edhe pa pëlqimin e tyre në një gjykatë fqinje; dhe pika e dytë ku thuhet se : duhet të caktohet qartë periudha kohore e transferimit të gjyqtarëve; më pas pika tre -gjyqtarët të mos ulen në detyrë p. sh.një gjyqtar për krime të rënda të mos dërgohet në një gjykatë tjetër për krime për të mitur. Gjithashtu, paga të jetë e njëjtë edhe në gjykatën ku ai transferohet. Të gjitha këto që, sipas Dren Ajetit, ishin pikat kryesore që Grupi për Studime Juridike dhe Politike mendon se duhet ndryshuar në këtë ligj.

Armend Zemaj – Në fjalën e tij të sërishme tha se kur flitet për Këshillin Gjyqësor duhet pasur parasysh që nuk është vetëm një individ, por dihet se Këshilli ka trembëdhjetë anëtarë dhe se sipas Zemajt është rrugë e gjatë që të bëhen këto lëvizje të gjyqtarëve, kur dihet se propozimet vijnë nga kryetarët e gjykatave dhe transferimi bëhet sipas rregullave që i përcakton Këshilli Gjyqësor, ndërsa në lidhje me lëndët e grumbulluara, deputeti Zemaj tha se ka rajone të cilat janë më të ngarkuara me lëndë dhe duke pasur parasysh që Kosova nuk është vend i madh si Gjermania apo Turqia, nuk do të ketë nevojë që të përmendet fjala “fqinje”. Ai më pas shtoi se vërejtjet nga grupi për Studime Juridike dhe Politike duhet t’i ketë parasysh Këshilli Gjyqësor.

Kryesuesja -Theksoi se vërejtjet që janë bërë nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike nuk mund të jenë të gjitha pjesë e ligjit, pasi sipas saj duhet të jenë pjesë e një udhëzimi administrativ, e në këtë rast pjesë e një rregulloreje. Këshilli gjyqësor duhet të ketë parasysh statutin, ligjet dhe Kushtetutën dhe se askush kundër vullnetit nuk mund të transferohet, pasi që janë të mbrojtur, si për shërbyesit civilë gjithashtu edhe për gjykatat dhe transferimet bëhen me nivel të njëjtë të pagës. Më pas ajo theksoi se secili institucion ka të drejtë të miratojë akte dhe është i obliguar që t’i publikojnë në ueb- faqet e tyre, me qëllim që puna e tyre të jetë

transparente. Komisioni, sipas znj. Halimi, e ka për obligim që, nëse sheh ndonjë akt i cili bie në kundërshtim me konventat evropiane ose ndonjë kundërshtim tjetër ligjor, të reagojë.

Armend Zemaj - Nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kërkoi sqarim se çka mendojnë saktësisht dhe pse ka ardhur kjo normë më e gjerë se sa nga ajo çka ministri ka thënë në fjalën e tij?

Ardian Bajraktari - Sqaroi se përmes këtij plotësimi ndryshimi janë synuar dy çështje. E para, t'u jepet mundësi transferimit të gjyqtarëve në një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, dhe e dyta që të përcaktohet baza me ligj, kurse detajet e tjera të jenë përgjegjësi e Këshillit Gjyqësor, që ato të rregullohen me rregulloren përkatëse të Këshillit, theksoi z. Bajraktari.

Nezir Çoçaj - Tha se nuk duhet të futen në ligj këto ndryshime meqenëse ekziston një rregullore e Këshillit Gjyqësor, e cila përcakton qartë punën e gjyqtarëve. Gjithashtu, z. Çoçaj tha se pajtohet me parafolësit që, për transferim të një gjyqtari, nuk ka nevojë të thirren të gjithë kryetarët e gjykatave, por mjafton vetëm kryetari i gjykatës përkatëse.

Në fund, meqë nuk pati diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se, Komisioni me shumicë votash, i rekomandon Kuvendit Raportin me amendamente dhe vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit, komisioneve kryesore t'ua paraqes këtë:

R e k o m a n d I m

Për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115.

Amendamenti 1

Në nenin 1 paragrafi 1, të Projektligjit, fjalët “kryetarëve të gjykatave” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “kryetarit të gjykatës përkatëse” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Në nenin 1 paragrafi 2, shtohen fjalët “rregullorja për transferim dhe caktim të gjyqtarëve nxirret brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji”.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

E përgatiti;
Njësia për mbështetje të Komisionit,
Mirlinda Kolgeci

Nënkryetarja e Komisionit,
Selvije Halimi